



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:019266
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05441308

C.nr.127/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K., nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson Halim Kuliqi, avokat në Drenas, kundër të paditurit Spitali Special për Sëmundje Kardiovaskulare ish “H...”, tani I.H., me seli në Gjakovë, me objekt kontesti: kompensim demi material, duke vepruar sipas aktgjykimit Ac.nr.3402/16, të datës 30.12.2019, jashtë seancës, me 12 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

DETYROHET i padituri Spitali Special për Sëmundje Kardiovaskulare ish “H...”, tani I.H., me seli në Gjakovë, që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,187.00 euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Historiku procedural

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij me datë 29.08.2012, ka paraqitur padi për kompensim demi material, kundër të paditurve Spitali Special për Sëmundje Kardiovaskulare ish “H.”, tani I.H., me seli në Gjakovë dhe H.B., nga Gjakova.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, me aktgjykimin C.nr.281/12, të datës 18.07.2016, ka vendosur lidhur me padinë.

Pas paraqitjes se ankesës ndaj aktgjykimit të lartcekur, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.3402/16, të datës 30.12.2019, çështjen e ka kthyer në rishqyrtim vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Baza ligjore

Me nenin 449 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është paraparë se *“Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor”*, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *“Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit”*.

Neni 452 paragrafi 1 i LPK-së, parasheh se *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, tutje paragrafi 2, i këtij neni parasheh se *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*.

Tutje neni 463, paragrafi 4 i LPK-së, ka paraparë se *“Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës lidhur me shpenzimet e procedurës

Gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore të cekura si me lartë, dhe pas vlerësimit të veprimeve të ndërmarra nga i autorizuari i paditësit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të udhëhequr sipas shenjës C.nr.281/12, erdhi në përfundim se shuma e përgjithshme e cila i takon paditësit në emër të shpenzimeve procedurale është në shumë prej 2,187.00 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve si në vijim: në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore për padi shumë prej 86.00 euro, për 2 seanca të shtyra pa fajin e paditësit, shumë prej 270.00 euro (për secilën seancë shumë prej 135.00 euro), për 6 seanca të mbajtura gjyqësore shumë prej 1,620.00 euro (për secilën seancë të mbajtur shumë prej 270.00 euro), si dhe për ekspertizë financiare shumë prej 107.00 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.127/20, më 12 mars 2024

GJ Y Q T A R
Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.